AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP), TM2 2023 (e rishikuar)

01.09.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë (TM2) 2023, viti bazë 2010=100.

Çmimet e importit më të larta në TM2 2023 sesa në TM2 2022

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë u ngrit për 0,4% në TM2 2023, krahasuar me TM1 2023. Ndërkaq, krahasuar TM2 2023 me TM2 2022 çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 4,2%.



Tremujori i dytë 2023 / Tremujori i parë 2023 0,4%

Çmimet e importit në Kosovë patën një ngritje në një mesatare prej 0,4% në TM2 2023, krahasuar me TM1 2023. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale, muzikore dhe mekanizmat e orës (14,5 %); tekstili dhe artikujt e tekstilit (11.9%); lëkura dhe artikujt e saj (11,5%) etj.

Ngritja u neutralizua, kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: vajrat ushqyese (-12,3%); produktet bimore (-5,4); produktet minerale (-4,6); këpucët (-3,4%); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-2,2%) etj.

Tremujori i dytë 2023 - Tremujori i dytë 2022 4,2%

Çmimet e importit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 4,2% në TM2 2023, krahasuar me TM2 2022. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: letra dhe artikujt prej saj (25,5 %); tekstili dhe artikujt e tekstilit (17,9 %); produktet bimore (15,0%); instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale, muzikore dhe mekanizmat e orës (13,5%); mjetet e transportit (12,8 %); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (10,5%) etj.

Ngritja u neutralizua, kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: vajrat ushqyese (-11,5%); produktet minerale (-7,4%); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-5,9 %); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-5,2 %).

Ndryshimet tremujore dhe vjetore në % sipas sektorëve

Grupi	Pesha	TM2- 2023 2010 =100	TM2 - 2023 TM1-2023	TM2 - 2023 TM2 - 2022
IÇIMP - Gjithsej	**1000**	**162,5**	**0,4**	**4,2**
Shtazët e gjalla; produktet e shtazëve	38	180,6	-0,5	9,5
Produktet bimore	50	316,8	-5,4	15,0
Vajrat ushqyese	10	205,3	-12,3	-11,5
Artikuj ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani	131	133,5	3,4	10,5
Produktet minerale	147	225,0	-4,6	-7,4
Produktet e industrive kimike	80	126,6	0,0	7,4
Plastika,kauçuku dhe artikujt e tyre	64	158,1	-2,2	-5,2
Lëkura dhe artikujt e saj	2	122,9	11,5	10,2
Druri dhe artikujt e tij	26	182,3	-1,7	0,3
Letrat dhe artikujt e saj	16	132,5	4,8	25,5
Tekstili dhe artikujt e tekstilit	44	102,2	11,9	17,9
Këpucët	12	143,2	-3,4	1,4
Artikutj e gurit, të llaçit, produktet e keramikës dhe te qelqit	34	195,2	-0,8	9,4
Margaritarët, gurët e çmuar, metalet, etj.	:	:	:	:
Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	100	170,6	-2,1	-5,9
Paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike	118	122,4	0,3	3,2
Mjetet e transportit	88	147,9	6,7	12,8
Instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës	10	127,8	14,5	13,5
Armët dhe municioni	:	:	:	:
Artikujt e ndryshëm të prodhuar	28	131,7	1,9	3,2
Veprat e artit	:	:	:	:

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Çmimeve të Importit (IÇIMP) për TM2 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation